

**STATUT I SHOQERISE**  
**"ZITA" SHPK**

Ne Tirane, sot me date 15.06.2021, me cilesine e Ortakut te Vetem **Znj. Brunilda Hasanllari**, e bija e Zija-it, lindur me date 19.04.1979, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, me adrese: Rruga "Nikolla Jorga", Nd. 14, Shk. 7, Ap. 19, Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga Pasaporta me Nr. Personal H95419166W, e cila ne cilesine e "ortakut te shoqerise", me vullnet te lire dhe te plote, mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin: "**ZITA**" SHPK me poshte e quajtur "Shoqeria", miraton Statutin e Shoqerise me permbajtje si me poshte vijon:

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqeria "**ZITA**" SHPK, eshte person juridik i se drejtes shqiptare. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me poshte e quajtur "Shoqeria".

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqeria e ka seline ne ne Tirane, Njesia Administrative Nr.5, Rruga Janos Hunyadi, Ndertesha nr.34, kati perdhe, Kodi Postar 1019.

**Neni 4**

**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Neni 5**

**Objekti i veprimtarise**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise:

Ofrimi i konsulencave dhe sherbimeve te te gjitha llojeve si, financiare, fiskale, ligjore, per çdo lloj shoqerish, te huaja apo vendase, publike apo private tregtare apo jofitimpruese, si dhe ushtrimi i çdo lloj aktiviteti tjeter qe do te kerkohet nga klientela e tregut;

-Sherbime konsulence financiare, asistence ne lidhje me legjislacionin fiskal dhe pershtatja me strukturat e kompanive; Asistence ne njohurite kontabile; Organizimin e formateve te strukturave dhe raporteve financiare; Auditimin e pasqyrave financiare mujore; Ndjekje e marrdhenieve me bankat per: kredite, Sistemin e Pagesave, Kerkesave Specifike; Ndjekje dhe asistence ne marrdheniet me Institucionet Fiskale etj.



- Menaxhimi i burimeve njerezore; Ndermjetesim per punesim; Mbajtjen e dosjeve te personelit; Ndjekjen e praktikave te punesimit;
- Konsulence juridike; Sherbime juridike (Kontrata, kerkesa si dhe akte te ndryshme ligjore); Pergatitja e dokumentacionit dhe ndjekja e procedurave me institucione te ndryshme, Gjykata, QKB, Bashki etj.; Menaxhim i dokumentacionit Ligjor, etj.;
- Sherbime te ndryshme Logjistike; Organizimi i transportit te mallrave per import, eksport; Ndjekja e procedurave doganore; Ndjekja e procedurave te magazinave doganore etj.;
- Menaxhim i Aseteve dhe procedurave lidhur me to; Sherbime mjete transporti; Sherbime blerje-levizje ose zevendesim asete; Sherbime mirembajtje ambjente dhe asete etj.
- Sherbime marketingu, konsulenca te ndryshme lidhur me fushat e marketingut dhe telemarketingut; Formatime, adaptime dizajni per web, rrjete sociale etj.
- Sherbime IT, Konstatimi i problemeve dhe kordinimi me per zgjidhjen e tyre; mirembajtje rrjeti; siguria e informacionit etj.
- Sherbime Security; Koordinim me shoqerite e security; Monitorim te sigurise se objektit me sistem kamerash e alarmi etj.
- Aktivitet tjetër që përputhet me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe që konsiderohet nga shoqëria me përfitim dhe i dobishëm për arritjen e objektivave të saj kryesore.

**Neni 6**  
**Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

**KREU II**

**KAPITALI**

**Neni 7**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njqind mijë) leke**, i përbërë nga një kuotë e vetme me vlerë të përgjithshme **100.000 (njqind mijë) leke**, e cila përben **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

*Ortaku themelues i Shoqërisë "ZITA" SHPK, Znj. Brunilda Hasanllari është zotëuese e 1 (një) kuotë me vlerë 100.000 (njqind mijë) leke, e cila përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

**Neni 8**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të vetëm në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel të autorizuar, në rast se ka të tilla, të pakten 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut të vetëm të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar në një vlerë me të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij



statuti, e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale.

Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter. Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragrafi, çdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise. Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

#### **Neni 9**

#### **Transferimi i kapitalit**

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve. nepermjet akteve ligjore.

### **KREU III**

### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 10**

#### **Organi Vendimmarres**

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:
  - Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
  - Ndryshimet e statutit;
  - Emerimin e shkarkimin e administratorit/ve;
  - Emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
  - Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
  - Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
  - Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "e" te pikes 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
3. Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhën regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:
  - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

- Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investime;
- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

4. Ortaku i vetem mund te perfaqesohet edhe nga nje tjetër person, nepermjet prokures.
5. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

#### **Neni 11**

##### **Menyra e thirrjes**

1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

#### **Neni 12**

##### **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 13**

##### **Administrimi**

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise.

Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake te shoqerise.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte Znj. Brunilda Hasanllari.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe **pese vjeçare**, sipas ligjit.

#### **Neni 14**

##### **Kompetencat**

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te



shoqerise;

- Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- Krijone nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- Raportojte perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te Jashtezakonshem;
- Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve;
- Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise;
- Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj;
- Administratori ka gjithashtu te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshire ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerive te tjera ku Shoqeria eshte ortak;
- te nenshkruaje e hartojte çdo dokument e te kryeje ne emer te Shoqerise çdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te Shoqerise, nenshkrimi i kontratave te ndryshme bankare per financimin e Shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdhje shumash nga keto llogari pa limit;
- Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke pasur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme;
- Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet;
- Administratorit ose ortakut qe nuk eshte person juridik, nuk u lejohet te kontraktojne ne çfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme;

#### Neni 15

#### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.



Pasojat e marreveshjeve te pa miratuara nga ortaku i vetem qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese. Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka te drejte te ngre padi penale kunder administratorit.

Ortaket kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Ortaku qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne çdo kohe te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Bilanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se fitimit neto, fitim i cili pasqyrohet nga pasqyrat financiare vjetore, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji; gjithashtu edhe pasi te jene zbritur te gjitha shumat qe Asambleja e Pergjithshme e Ortakut te Vetem ka vendosur te lere menjane, i shperndahen Ortakut te Vetem Shoqerise.

Asambleja vendos nese do te mbaje ose jo shuma te caktuara si rezerva, apo te shtyje shperndarjen e fitimeve neto te percaktuara ne pasqyrat financiare vjetore, teresisht apo pjeserisht, ne vitet ushtrimore pasardhes.

#### **Neni 18**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t' ja paraqese e dorezoje ne kohe Ortakut te vetem per t' i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### **Neni 19**

##### **Bilanci**

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Ortaku i vetem. e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshe te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

## Neni 20

### Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfare do shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshe me te veprimtarise se saj;
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

## Neni 21

### Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria. me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja. Ortaku i vetem e shoqerise, qe ben kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfiton pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompensim me para, vlere e te cilit nuk mund te kaloje 10 per qind te vleres nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena. Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

## KAPITULLI IV LIKUIDIMI I SHOQERISE

### Neni 22

#### Emertimi i likuidatorit

Afati i emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentet qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrit Tregtar.

### Neni 23

#### Likuidimi

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve, debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

**KAPITULLI V**  
**DISPOZITAT E FUNDIT**

**Neni 24**

**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 25**

**Mosmarveshjet**

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.


**Neni 26**

**Dispozita perfundimtare**

Ky statut u hartua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "ZITA" SHPK nenshkruset ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

BRUNILDA HASANLLARI

  
Brunilda Hasanllari